



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 12.02.2025

Nr: 85

Ora: 12:00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 11, DATË 11.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA**

Sot më datë 12.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Arsimit dhe Sportit
Z. Petrit Malaj, Ministër i Financave
Z. Blendi Gonxhe, Ministër i Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit
Zj. Belinda Balluku, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë
Z. Ervin Hoxha, Ministër i Brendshëm

OBJEKT: Përdorimi i sloganeve dhe hashtag-eve në postimet e aktiviteteve institucionale të ministrive

BAZA LIGJOR: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

K O N S T A T O J :

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara, më datë 11.02.2025, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve një denoncim.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 11, në datën 11.02.2025.

Nga shqyrtimi paraprak i të dhënave që përmban denoncimi si dhe dokumentat bashkëlidhur tij pretendohet si vijon:

Data: 12.02.2025

Nr: 85
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 11, datë 11.02.2025 të regjistrin të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara”

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, prej nisjes së periudhës katërmujore më datë 11 janar 2025 e deri më sot, në një pjesë të konsiderueshme të Faqeve Zyrtare në Facebook të Ministrive në vend janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve (#) dhe konkretisht: #KrenarPërShqipërinë; #VetëmPërpara; #Shqipëria2030.

Këto tre slogane/hashtag-e lidhen dhe identifikojnë drejtpërsëdrejt Partinë Socialiste me maxhorancën e deputetëve në Kuvend, e cila, megjithëse ende nuk është regjistruar zyrtarisht si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e 11 majit, e ka filluar tashmë de facto botërisht fushatën elektorale duke kërkuar të votohet dhe mbështetet në zgjedhjet e 11 majit 2025.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në facebook e Ministrive të mëposhtme:

- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Financave;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë;
- Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Brendshme.”

Nga sa më sipër çmuj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Ogerta Manastirliu, Ministër i Arsimit dhe Sportit;
 - Z. Petrit Malaj, Ministër i Financave;
 - Z. Blendi Gonxhe, Ministër i Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit;
 - Zj. Belinda Balluku, Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
 - Z. Ervin Hoxha, Ministër i Brendshëm.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Kopje: 3
Afati i ruajtjes: 5 vjet
Punoi:
I.Horanlliu _____
P. Doçaj _____
A.Lamçe _____
M.Çelmeta _____